



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr.595/12

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Valon Totaj, me procesmbajtësen Drita Qerreti, në kontestin e paditësit të mitur E. B. nga P. rr....., llam. ..., nr..., të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor - i ati i tij Q. B., e të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. V. O. nga Prizreni, kundër të paditues Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” nga Prishtina, lagjja K., blloku .., nr..., për shkak të kompensimit të dëmit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 27.07.2015, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit të mitur E. B., të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor i tij - i ati i tij Q. B., andaj **detyrohet** e paditura K.S “Kosova e Re” nga Prishtina, që në emër të dëmit material dhe atij jomaterial, t’ia kompenzoj paditësit shumat si në vijim:

- për dhimbjet fizike (trupore), shumën prej 3.000 euro;
- për frikë, shumën prej 2.500 euro;
- për dhimbjet shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 27.5%, shumën prej 9500 euro;
- për shëmtim, shumën prej 1800 euro,
- për ndihmën e personit të tretë, në formë të rentës së gjithëmbarshme të kapitalizuar, shumën prej 1.128,50 euro;
- për ushqim të përforcuar, shumën prej 700 euro;
- për veshmbadhje, shumën prej 150 euro dhe
- për shpenzimet e udhëtimit dhe të mjekimit, shumën prej 2.972,73 euro dhe
- për shpenzime të shërimit klimaterik 1.000 euro, respektivisht shumën e përgjithshme prej **22.751,23 euro**, me kamatë sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit e pa destinim të caktuar që paguhet në bankat komerciale të Kosovës, duke e llogaritur atë nga dita shkaktimit të aksidentit e deri te pagesa definitive, të gjitha këto brenda afatit 15 ditor, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

II. Detyrohet e paditura që t’ia paguaj shpenzimet procedurale paditësit dhe atë në lartësi prej **1.875,00 euro**, në afatin prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

III. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit të mitur E. B. nga P., të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor i tij - i ati i tij Q. B., nga shuma e aprovuar sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e kërkuar prej 31.123,19 euro, **refuzohet si e pabazuar.**

Arsyetim

Shqyrtimi kryesor është mbyllur në mungesë së palës së paditur, konform nenit 423 parag. 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi E. B., përmes përfaqësuesit të tij ligjor - babait të tij Q. B., respektivisht të autorizuarit të këtij të fundit avokatit V. O. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë për kompensimin e dëmit material dhe jo material, kundër të paditues K.S. “Kosova e Re” me seli në Prishtinë, duke theksuar se me datën 10.05.2011, rreth orës 11:45 minuta, në rrugën në Prizren, për në drejtim të rrugës, pikërisht në kryqëzimin e rrugës, në rrugën ..., kishte ndodhur aksidenti i komunikacionit, në të cilin kishin marrë pjesë edhe E. B., i cili kishte filluar të kaloj rrugën nga ana e majtë e vozitësit, për në anën e djathtë, e që kishte qenë duke i hedhur mbeturinat në kontejner, por që i njëjti nuk ishte vërejtur nga vozitësi E. B., i cili drejtonte automjetin e markës “Land Rover” të tipit “Defander”, numri i regjistrimit *numri i targës...*, me numër të shahisë SALLDHF583A652119, ku pasi që e vëren këmbësorin, këtu paditësin e mitur E. B., frenon por në pamundësi që të ndalet, me gomën e përparme të anës së majtë e godet këmbësorin në anën e djathtë, duke i shkaktuar frakturë, përkatësisht lëndime të rënda trupore. Sipas padisë automjeti me përdorimin e të cilit është shkaktuar aksidenti, kishte qenë i siguruar tek Kompania e Sigurimit “Kosova e Re”, përkatësisht këtu e paditura. Si rezultat i këtij aksidenti, paditësi i mitur E. B., kishte pësuar lëndime jashtëzakonisht të rënda me pasoja të përhershme për jetë, ku për shkak të këtyre lëndimeve ai është shëruar në Spitalin Regjional të Prizrenit, Qendrën Emergjente në Prizren, ndërsa shërim më të specializuar ka marrë pastaj në Republikën e Maqedonisë, përkatësisht edhe në Republikën e Turqisë, më gjerësisht sikurse në padi.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari i përfaqësuesit ligjor të paditësit av. V. O. nga Prizreni, kryesisht ka ngelur pranë padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar të datës 05.03.2015, me ç’rast ka kërkuar nga këtu e paditura që kompensimi për të gjitha llojet e dëmit të jetë 31.194,49 euro, si dhe shpenzimet e procedurës. Në fjalën e tij të fundit i autorizuari i përfaqësuesit ligjor të paditësit të mitur av.V. O. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë, kërkesëpadisë si dhe precizimit të kërkesëpadisë duke theksuar se nga administrimi i provave është vërtetuar fakti se përgjegjësia për kompensimin e dëmit material dhe jo material për shkak të aksidentit të datës 10.05.2011, i takon këtu të paditues K.S “Kosova e Re”, me seli në Prishtinë. Ndër të tjera ka kërkuar që padia dhe kërkesëpadia të aprovohet në tërësi dhe të obligohet e paditura që të bëjë pagesën në emër të kompensimit të dëmit dhe atë si në vijim: për dhimbjet fizike në shumën prej 5.000 euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësor në shumën prej 10.000 euro, për frikë në shumën prej 5.000 euro, për shëmtim trupor shumën prej 2.000 euro, për ndihmë të huaj shumën prej 1.128.55 euro, për ushqim të përforëcur shumën prej 1.400 euro, për mjekim dhe atë për udhëtimin në Republikën e Turqisë sipas faturave të administruar si provë në shumën prej 1086.53 euro, si dhe për shpenzimet e mjekimit në shumën prej 2908.11 euro, përkatësisht shumën e komepsimit në emër të mjekimit prej 3994.49 euro, për shërim fiziko-terapeutik-klimaterik, në shumën prej 2400 euro, për veshmbathje në shumën prej 200 euro, përkatësisht shumën e tërësishme të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial prej 31.123,19 euro, duke llogaritur edhe kamatën ligjore prej ditës së dorëzimit të padisë e deri në pagesën definitive. Po ashtu i ka kërkuar edhe

shpenzimet e procedurës në shumën prej 1875 euro, më gjerësisht të specifikuara sikurse në sikurse në fjalën përfundimtare të datës 27.07.2015.

Edhe pse e autorizuar e paditëses N. B. nuk ka prezantuar në seancën e fundit të shqyrtimit kryesor, ajo në seancat e kaluara si dhe në përgjigjen në padi ka deklaruar se e kundërshton pjesërisht padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, si për nga baza e ashtu edhe për nga lartësia e shumës së kërkuar. Sipas saj, kontribut në këtë aksident ka edhe vetë paditësi i mitur E. B., duke pretenduar se përgjegjësia është e ndarë 70 me 30, d.m.th 70% është përgjegjësia e të siguruarit tek e paditura, ndërsa 30%, te vet paditësi i mitur E. B. Kësisoj, në seancën e datës 29.05.2015, e autorizuar e të paditurës ka propozuar që kjo çështje kontestimore të zgjidhet me marrëveshje, ku për të gjitha llojet e dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 10.05.2011, ajo e ka ofruar shumën prej 11.305 euro. Për shumën tjetër të kërkuar sikurse në precizimin e kërkesëpadiisë së paditësit, gjykatës i ka kërkuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar. Ndër të tjera gjykatës i ka propozuar që edhe pjesën e kërkespadiisë e cila ka të bëjë me shumën e kërkuar për shërim jashtë vendit, ta refuzoi, pasi që nuk ka një mendim nga QKUK-ja në Prishtinë, që trajtimi të bëhet jashtë territorit të Republikës së Kosovës, ndërsa për shpenzimet e procedurës i'a ka lënë në vendosje gjykatës.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: raportin policor mbi aksidentin me nr. 2011-GR-0471, i datës 10.05.2011; raportin mjekësor të Qendrës Emergjente të spitalit rajonal në Prizren me numër 8817, të datës 10.05.2011; fletëlëshimin e spitalit regional të Prizrenit me numër të historisë 7810, të datës 17.05.2011; aktakuzën e Prokurorisë Komonale në Prizren me numër PP.nr.1933/11, të datës 11.07.2011; konstatimin dhe mendimin e ekspertit të komunikacionit rrugor bashkë me skicën përcjellëse të ekspertit M. M., të datës 09.07.2011; certifikatën e lindjes për paditësin E. B., me numër rendor 232, të lëshuar nga Komuna e Prizrenit; udhëzimet për konsultim të datës 27.07.2011 dhe 22.05.2011; raportin mjekësor të ambulancës "Sistina", me numër 104422, të datës 28.06.2011; fletëlëshimin e ambulancës "Sistina", me numër të kodit 104422, të datës 12.07.2011; raportin e mjekut të ambulancës "Sistina", me numër 104422, të datës 18.08.2011; raportin e mjekut të ambulancës "Sistina", me numër 104422, të datës 22.09.2011; raportin e mjekut të ambulancës "Sistina", me numër 104422, të datës 27.10.2011; dokumentacionin mjekësor të spitalit turk "Uludag", të datës 22.06.2011, me numër rendor 1,6; fletëdaljen e klinikës së datës 22.06.2011; faturën e ambulancës "Sistina", të datës 27.10.2011, bashkë me kuponin fiskal; faturën e ambulancës "Sistina", të datës 28.06.2011, bashkë me kuponin fiskal; faturën e ambulancës "Sistina", të datës 11.07.2011, bashkë me kuponin fiskal; faturën e ambulancës "Sistina", të datës 12.07.2011, bashkë me kuponin fiskal; faturën e ambulancës "Sistina", të datës 18.08.2011, bashkë me kuponin fiskal; faturën e ambulancës "Sistina", të datës 22.09.2011, bashkë me kuponin fiskal; faturën e spitalit Turk "Uludag", me numër serik 0561035, të datës 22.06.2011, bashkë me specifikacionin përcjellës të shpenzimeve; kopje të biletave të udhëtimit Reiseburo Prishtina, të datës 29.05.2011, 22.06.2011, 22.06.2011, 12.05.2011, 12.05.2011 dhe 12.05.2011; në aktgjykimin e plotfuqishëm penal me numër P.nr.982/11, të datës 26.08.2013; është bërë dëgjimi i ekspertit mjekoligjor – ortoped-traumatolog dr. Xh. S. nga Prishtina; është bërë dëgjimi i ekspertit të psikiatrisë dr.N. F., nga Prizreni; është bërë dëgjimi i dëshmitarit – përfaqësuesit ligjor të paditësit Q. B.; si dhe është bërë leximi në ekspertizën e ekspertit të aktuaristikës A. G., të datës 30.06.2015.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkespadia e paditësit, është pjesërisht e bazuar.

Nga leximi në raportin policor mbi aksidentin me nr. 2011-GR-0471, të datës 10.05.2011, gjykata e ka provuar faktin se me datën 10.05.2011, rreth orës 11:45 minuta, kishte ardhur deri te aksidenti i komunikacionit, ashtu që vozitësi i veturës “Land Rover”, i tipit Defender, i vitit 2003, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, ngjyrë të bardhë, përderisa ishte duke lëvizur përgjatë rrugës ..., për në drejtim të rrugës ..., me të arritur në kryqëzimin e rrugës ... me rrugën ..., ku në atë moment kishte pasur trafik të shtuar dhe si pasoj e vozitjes së pakujdesshme nga vozitësi E. B., nuk e ka vërejtur këmbësorin, i cili kishte filluar të kaloj rrugën, nga ana e majtë e vozitësit për në anën e djathtë, e i cili kishte qenë për t’i hedhur mbeturinat në kontejner, ku vozitësi me të vërejtur këmbësorin frenon, por në pamundësi që të ndalet me gomën e përparme të anës së majtë e godet këmbësorin në këmbën e djathtë duke i shkaktuar fraktura, ku më pas dërgohet në spitalin e Prizrenit për mjekim të mëtejshëm. Automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti, i markës “Land Rover”, i tipit Defender, i vitit 2003, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, ngjyrë të bardhë, në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë i regjistruar te këtu e paditura K.S “Kosova e Re”.

Nga leximi në raportin mjekësor të Qendrës Emergjente të spitalit rajonal në Prizren me numër 8817, të datës 10.05.2011, gjykata e ka provuar faktin se paditësi E. B. është dërguar në emergjencë nga një kalimtar i rastit, i cili kishte qëlluar në vendin e ngjarjes, ku pas kontrollimit rreth orës 12:00, këtu paditësi ishte transferuar për në repartin e ortopedisë, më gjerësisht sikurse në këtë raport.

Nga leximi në fletëlëshimin e spitalit regjional të Prizrenit me numër të historisë 7810, të datës 17.05.2011, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi është shtruar në repartin e ortopedisë me datë 10.05.2011 dhe ka dalë me datën 17.05.2011, i cili është konstatuar me këtë diagnozë “Car accident, fractura aperta cruris vuln ap, pedis dex”, i cili edhe është rekomanduar për trajtim kirurgjikal në një klinikë të specializuar jashtë vendit, më gjerësisht sikurse në këtë fletëlëshim.

Nga leximi në konstatimin dhe mendimin e ekspertit të komunikacionit rrugor bashkë me skicën përcjellëse të ekspertit M. M., të datës 09.07.2011, gjykata ka konstatuar se aksidenti është klasifikuar si “goditje frontale e këmbësorit nga ana e veturës në lëvizje drejtë”, ku si pjesëmarrës në aksident ishin vetura “Land Rover”, e tipit “Defender”, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, pronë e “KRU Radoniqi Dugagjini” sh.a, të cilën në momentin kritik e ka drejtuar E. B., 61 vjeçar, me vendbanim në rr... në Prizren, i cili posedon patent shoferin për kategorin “B dhe C”, si dhe këmbësori E. B., i lindur në vitin ..., me vendbanim në rr..., llam .., nr..., i cili në aksident kishte marr lëndime të rënda si frakturë të hapur në këmbën e djathtë. Sipas mendimit të ekspertit të komunikacionit në ditën kritike rruga ishte në gjendje të mirë, koha ishte e mirë e po ashtu edhe dukshmëria, në vendin e ngjarjes kishin mbetur gjurmët e frenimit (rrota e parë majtas), gjurmët e gjakut, këpuca e djathtë e këmbësorit si dhe qesja me mbeturina. Ndër të tjera në përfundim e kësaj ekspertize ka deklaruar se deri te aksidenti ka ardhur si

pasoj e lëshimeve teknike të ngasësit të veturës së lartcekur, ku i njëjti nuk e ka përshtatur shpejtësin e lëvizjes së veturës kushteve dhe rrethanave të komunikacionit në rrugën në të cilën ka lëvizur, dhe si pasojë e lëvizjes së pakujdesshme, e ka humbur mundësin e vërejtjes së rrezikut, këmbësorin në rrugë dhe reagimin me kohë, e që po të kishte lëvizur me kujdes të shtuar dhe me shpejtësi të përshtatshme kushteve dhe rrethanave të rrugës që kanë mbretëruar në atë ditë, kishte për ta parë këmbësorin në rrugë dhe do të kishte reaguar me kohë, më gjerësisht sikurse në këtë ekspertizë, e cila ka të bashkangjitur edhe skicën përcjellëse.

Nga leximi në certifikatën e lindjes për paditësin E. B., me numër rendor 232, të lëshuar nga Komuna e Prizrenit, gjykata e ka provuar faktin e lindjes për paditësin në fjalë dhe se i njëjti ka lindur më datën 03.01.2004, në Prizren, më gjerësisht sikurse në këtë certifikatë.

Nga leximi në udhëzimet për konsultim të datës 27.07.2011 dhe 22.05.2011, gjykata e ka provuar faktin se këtu paditësi, për shkak të natyrës së lëndimit, është udhëzuar për shërim jashtë vendit, më gjerësisht sikurse në këtë udhëzim.

Nga leximi në faturën e ambulancës “Sistina”, të datës 27.10.2011, bashkë me kuponin fiskal, gjykata e ka provuar faktin se në emër të paditësit, për trajtim mjekësor, kësaj klinike i është paguar shuma sikurse në këtë faturë.

Nga leximi në faturën e ambulancës “Sistina”, të datës 28.06.2011, bashkë me kuponin fiskal, gjykata e ka provuar faktin se në emër të paditësit, për trajtim mjekësor, kësaj klinike i është paguar shuma sikurse në këtë faturë.

Nga leximi në faturën e ambulancës “Sistina”, të datës 11.07.2011, bashkë me kuponin fiskal, gjykata e ka provuar faktin se në emër të paditësit, për trajtim mjekësor, kësaj klinike i është paguar shuma sikurse në këtë faturë.

Nga leximi në faturën e ambulancës “Sistina”, të datës 12.07.2011, bashkë me kuponin fiskal, gjykata e ka provuar faktin se në emër të paditësit, për trajtim mjekësor, kësaj klinike i është paguar shuma sikurse në këtë faturë.

Nga leximi në faturën e ambulancës “Sistina”, të datës 18.08.2011, bashkë me kuponin fiskal, gjykata e ka provuar faktin se në emër të paditësit, për trajtim mjekësor, kësaj klinike i është paguar shuma sikurse në këtë faturë.

Nga leximi në faturën e ambulancës “Sistina”, të datës 22.09.2011, bashkë me kuponin fiskal, gjykata e ka provuar faktin se në emër të paditësit, për trajtim mjekësor, kësaj klinike i është paguar shuma sikurse në këtë faturë.

Nga leximi në kopje të biletave të udhëtimit Reiseburo Prishtina, të datës 29.05.2011, 22.06.2011, 22.06.2011, 12.05.2011, 12.05.2011 dhe 12.05.2011, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu paditësi ka udhëtuar nga Prishtina për në Stamboll – Republikën e Turqisë, për shërim dhe se ka pasur shpenzime të caktuara sikurse në këto bileta.

Nga leximi në aktgjykimin e plotfuqishëm penal me numër P.nr.982/11, të datës 26.08.2013, gjykata e ka provuar faktin se E. B., i cili ka qenë duke e vozitur veturën me të cilën ditën kritike ka ndodhur aksidenti, e që e njehta (vetura) ka qenë e siguruar te këtu

e paditura, nga Gjykata Themelore në Prizren është shpallur fajtor me aktgjykim të plotfuqishëm ku ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 të KPK-së, ku edhe i është shqiptuar dënimi me kusht, më gjerësisht sikurse në këtë aktgjykim.

Në këtë aksident, paditësi i mitur E. B. ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe të nejtjit i është dhënë ndihmë mjekësore fillimisht në Qendrën Emergjente të Spitalit në Prizren, për të vazhduar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, Ambulancën “Sistina” në IRJM dhe spitalin “Uludag” në Republikën e Turqisë. Në bazë të fletëlëshimeve nga institucionet e lartëcekura, dokumentacionit tjetër mjekësor të cilat kjo gjykatë i ka administruar në cilësi të provave materiale si dhe në bazë të ekzaminimit të drejtëpërdrejtë dhe në prani të gjykatës të paditësit E. B., eksperti mjeko-ligjor dr. Xh. S. nga Prishtina, i’a ka parashtruar gjykatës në seancë mendimin e vet, të cilit mendim gjykata i’a fali besimin, duke gjetur - konstatuar se paditësi E. B. në këtë aksident të komunikacionit ka pësuar lëndime të cilat karakterizohen si lëndime të rënda trupore të cilat kanë shkaktuar: a) dhimbje fizike të intezitetit posaqërisht të rëndë 40 minuta (duke llogaritur momentin dhe vend ndodhjen e aksidentit, kohën e transportit, procedurat diagnostifikuese e deri te fillimi i mjekimit); b) të intezitetit të rëndë 5 ditë kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes; c) të intezitetit të mesëm 42 ditë (koha e nevojshme për konsolidimin parësor kockor si dhe fillimin e shërimit të defekteve lëkurore, të cilat kanë zgjatur me disa seanca operatore të mëvonshme); si dhe ç) të intezitetit të ulët sipas të dhënave nga bashkëbisedimi i drejtëpërdrejtë këto dhimbje ekzistojnë edhe sot e kësaj dite , të cilat përsëriten pas sforëcimeve fizike siç është ecja në distancë, ngjitja dhe zbritja shkallëve si dhe gjatë lojës. Sipas ekspertit në fjalë, paditësi ka pësuar zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, i cili është i shprehur në shkallën prej 27.5%, për shkak të: a) deformimit të shputës së këmbës së djathtë në raport me boshtin normal (shputa e këmbës shikon brenda dhe e ngritur nga jashtë *plano-valgus*, në shkallë të rëndë pika.217, dhe b) kufizimit të lëvizjes së nyllit të shputës së këmbës së djathtë në shkallë të lehtë pik.213 a, si dhe vrajave dhe defekteve lëkurore të thella në shpinën e shputës së këmbës së djathtë dhe në pjesën e përparme, të sipërme të kofshës së djathtë (për shkak të plastikës së lëkurës), pika 195 e tabelës mbi zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në lidhshmëri me pikën 3 të vërejtjeve hyrëse të kësaj tablele, e cila flet për lëndimet e shumë-fishta të një organi apo ekstremiteti dhe mënyrën e përcaktimit të invaliditetit. Shëmtimi trupor është i shkallës së mesme – për shkak të vrajës post operatore për shkake të plastikës së lëkurës, në pjesën e sipërme të përparme të kofshës së djathtë me përmasa 14x7 cm, pjesës së sipërme të brendshme të shputës së këmbës së djathtë me përmasa 15x7 cm dhe defekt lëkuror të theksuar, si dhe pozitës me shikim nga ana e brendshme e shputës së djathtë – të gishtit të madh (*haluxvalgus* dhe *pes plano valgus*), si dhe vrajave në pjesën e përparme të kërcirit të djathtë, të cilat janë gjithësej 5 për shkak të ndërhyrjes me shtiza dhe thyerjes së hapur me përmasa duke filluar nga sipër drejt pjesës së poshtme të boshtit 2x1cm, 1x1cm, 3cm, 1x1cm dhe 1x1cm. Ndihma e huaj ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 6 muajsh, duke llogaritur ndërhyrjet kirurgjike të njëpasnjëshme për shkak të defekteve muskulo-lëkurore, konsolidimit kockor dhe periudhave të nevojshme për shërim pas këtyre ndërhyrjeve. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 7 muajsh, i cili ka qenë i nevojshëm të jetë i pasuruar me proteina, albumina, karbohidrate, vitamina dhe minerale. Rehabilitimi fizioterapik klimatik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 30 ditësh brena vitit të parë pas aksidentit dhe 30 ditë të tjera për vitin e dytë pas aksidentit, më gjerësisht sikurse në procesverbalin e datës 16.02.2015.

Sa i përket shkallës së frikës së përjetuar të paditësit të mitur, eksperti i psikiatrisë i angazhuar në këtë çështje kontestimore dr. N. F. nga Prizreni, ka deklaruar se bazuar në shkresat e lëndës dhe egzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit të mitur E. B., me rastin e aksidentit në fjalë këtu paditësi përveq se ka pësuar lëndim të rëndë trupor, po ashtu ka pësuar edhe frikë primare, e cila ka zgjatur rreth një minutë e manifestuar me një stepje si pasoj e vërshimit intensiv të emocioneve si frika nga përfundimi fatal. Ai po ashtu ka pësuar frikë sekondare të intensitetit të lartë, e cila ka zgjatur rreth një javë e manifestuar me frikë, pagjumësi, brengosje për rrjedhën e mjekimit, si dhe dhimbjet që ka pasur në atë kohë. Ndërsa për një periudhë një mujore ka pësuar frikë sekondare të intensitetit të mesëm, e cila është manifestuar me brengosje të shumta, prishje të gjumit, ngacmueshmëri si dhe një shmangie nga përfshirja në aktivitetet që kanë të bëjnë me komunikacion. Përndimisht, sipas po këtij eksperti, paditësi ka pësuar edhe frikë sekondare të intensitetit të ulët, e cila ka zgjatur për një vit, e që është shprehur me rikujtime traumatike, ngacmueshmëri e shtuar si dhe nga kufizimet që ka pasur në përfshirjen në shkollë, në lojë etj, më gjerësisht sikurse në procesverbalin e datës 16.02.2015.

Nga dëgjimi i dëshmitarit – përfaqësuesit ligjor të paditësit - babait të tij Q. B., gjykata ka konstatuar se trajtimi i paditësit ka zgjatur rreth një muaj e gjysmë, i cili për tri ditë është realizuar në Prizren, pastaj ka vazhduar në Bursa të Republikës së Turqisë, përkatësisht në spitalin “Uludag”, për një muaj e gjysmë, ku pas kësaj është kthyer në shtëpi, ku paditësi përgjatë kësaj periudhe ka qenë i palëvizshëm, përkatësisht në këmbën e paditësit kanë qenë të fiksuara stabilizatorë – me bulona (shufra metalike) për rreth një muaj, që nënkupton se përgjatë këtij muaji ai ka lëvizur me një këmbë me ndihmën e personit të tretë, përkatësisht me ndihmën e familjarëve, të tij dhe të bashkëshortes së tij. Pas kësaj periudhe një mujore, shufrat janë mënjanuar nga paditësi në Qendrën Spitalore “Sistina”, në Shkup të Maqedonisë. Pas kësaj edhe për 6 muaj me radhë paditësi ka lëvizur me mbajtëse “paterica”, çka nënkupton se edhe përgjatë kësaj periudhe i njëjti ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë, duke filluar nga pastrimi i varrës në vendin e të cilës kanë qenë të vendosura shufrat, e deri te ndihma konkrete në lëvizje. Në muajin shtator paditësi ka filluar të shkoi në shkollë, por që i njëjti është dashur të ndihmohet nga personi i tretë edhe për 6 muaj radhazi, derisa është aftësuar që të shkoi në shkollë pa ndihmën e personit të tretë, më gjerësisht sikurse në procesverbalin e datës 19.05.2015.

Nga leximi në ekspertizën e ekspertit të aktuaristikës A. G., të datës 30.06.2015, gjykata ka konstatuar se me këtë ekspertizë paditësit i është llogaritur edhe kompensimi material për ndihmën dhe kujdesin e huaj në kohëzgjatje prej 6 muajve nga dita e aksidentit, në shumën prej 1.020,00 euro, me kamatë vjetore prej 3,50% dhe atë prej datës 15.06.2012 e deri me datën 31.12.2012 e cila kamatë kap në shumën prej 108,55 euro, respektivisht në shumën e tërësishme të kompensimit në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë prej 1.128,55 euro, më gjerësisht sikurse në ekspertizën e ekspertit aktuar A. G., të datës 30.06.2015.

Baza ligjore

Me nenin 154 al.1 të Ligjit mbi Marëdhëniet e Detyrimeve (LMD) të zbatueshme për këtë rast, është paraparë se ***“kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta***

kompensoj, në qoftëse nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”, ndërsa me nenin 178 të po këtij ligji është paraparë se “*në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar për faj të një poseduesi të automjetit, vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë*”. Sipas nenit 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se “*në procedurën kontestimore gjykata më pikpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor*”.

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Në bazë të lartëcekurave gjykata ka vërtetuar se e paditura është përgjegjëse ndaj këtu paditësit konform përgjegjësisë në bazë të fajësisë, të parashikuar me dispozitat e lartëcituara të nenit 178 al.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) dhe dispozitave mbi kompenzimin e dëmit konform shkallës së përgjegjësisë së tyre për dëmin material të shkaktuar, e të parapara me dispozitat e nenit 189 al.2 të LMD-së, si dhe dëmit jomaterial konform nenit 200 të LMD-së, e lidhur me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK). Në lidhje me kërkesat e aprovuara në shumatat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata është e mendimit se të njëjtat janë adekuate, e krejt kjo duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit dhe moshën e tij tejet të re dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t’i mundësoj të dëmtuarit – këtu paditësit të mitur E. B., satisfaksion, që ai të jetë në gjendje që deri në një masë, t’i kompenzoj të mirat jomateriale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ai do ta kishte poqëse të njëjtat nuk do t’i kishte humbur, e krejt kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre dhe kohën e nevojshme të shërimit, nevojat e shtuara të ushqimisë dhe mbi të gjitha zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 27.5 %, respektivisht pasojat e lëndimeve më afër të përshkruara si në mendimiet e ekspertëve të lartëcekur. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompenzimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash, gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe faktin që me të njëjtin, të mos u shkoj përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e këtij kompensimi dhe qëllimin e tij shoqëror. Po ashtu, me rastin e aprovimit të kërkespadsisë së paditësit sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, **gjykata mori për bazë edhe faktin se përgjatë shqyrtimit gjyqësor, përkatësisht në seancën e datës 29.05.2013, e autorizuar e të paditurit N. B., personalisht para gjykatës kishte deklaruar se vetëm pjesërisht e konteston bazën e kërkespadsisë së paditësit, me ç’rast për kompenzimin e të gjitha llojeve të dëmit të shkaktuar ndaj paditësit të mitur, ajo kishte ofruar shumën prej 11.305,00 euro, por për të cilën shumë nuk ishte dakorduar pala paditëse.**

Në lidhje me shpenzimet e mjekimit dhe udhëtimit, gjykata të njëjtat i aprovoi pjesërisht sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi ngase gjeti se paditësi i mitur në trajtimin e tij mjekësor, ka pasur shpenzime të konsiderueshme të mjekimit dhe të udhëtimit në lidhje me realizimin e këtyre shërbimeve dhe se për të njëjtat ai i ka ofruar kësaj gjykate faturat dhe dëshmitë e të tjera të lartëcakura, të cilat kjo gjykatë i ka administruar në cilësi të provave materiale dhe të cilave ua ka falur besimin. Për këtë arsye edhe vendosi që të njëjtat shpenzime t’i aprovoj në shumën sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi. Me rastin e aprovimit të këtyre shpenzimeve, gjykata nuk e mori për bazë kundërshtimin e të autorizuarës së të paditurës se nuk ka një mendim nga QKUK-ja

në Prishtinë, që trajtimi i paditësit të mitur të bëhet jashtë territorit të Republikës së Kosovës, ngase në udhëzimin e datës 22.05.2012, ekziston konstatimi zyrtar i mjekut nënshkrues të këtij udhëzimi se për shkak të natyrës së lëndimit, pacienti duhet të mjekohet jashtë Kosovës. Për më tepër edhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë, ekspertizave të ekspertëve mjeko ligjor të angazhuar në këtë çështje, fotove origjinale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe vrojtimit të drejtëpërdrejtë të paditësit nga gjykata, është provuar se për shkak të natyrës së lëndimit, trajtimi është dashur të bëhet në institucionet e specializuara mjekësore jashtë vendit, ngase ndër të tjera, paditësi i mitur ka pasur nevojë për transplantim të pjesës së lekurës së tij nga një gjymtyrë e trupit në gjymtyrën tjetër, gjë që në institucionet shëndetësore vendore, vështirë se ky proces do të mund të kryhej me sukses. Për këtë arsye gjykata i ka aprovuar këto shpenzime pjesërisht sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi. Pjesën tjetër të këtyre shpenzimeve të mjekimit dhe të udhëtimit, nga shuma e aprovuar e deri në shumën e kërkuar prej 3999.49 euro, gjykata e refuzoi ngase në bazë të provave të administruara në këtë procedurë, gjeti se e njëjta është e pabazuar.

Gjykata e aprovoi edhe pjesën e kërkespadiës e cila ka të bëjë me kompensimin e dëmit material për shkak të ndihmës së personit të tretë, në formë të rentës së gjithëmbarshme të kapitalizuar, shumën sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, ngase në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë, është konstatuar se paditësi i mitur vërtetë pa kasur nevojë për ndihmën e personit të tretë për periudhën e caktuar të cekur në ekspertizën mjeko ligjore dhe atë të aktuaristikës. Mbi bazën e këtij fakti, gjykata pastaj e ka angazhuar edhe ekspertin përkatës të aktuaristikës i cili përmes ekspertizës së tij, të cilës gjykata i'a ka fal besimin e plotë, këtë ndihmë të personit të tretë, e ka llogaritur dhe aprovuar në shumën konkrete të cekur sikurse më lartë.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese të kërkespadiës së paditësit të mitur, respektivisht shumës mbi shumat e aprovuara e deri te shuma e kërkuar për dhimbje fizike, për frikë, për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, për shëmtim, për ushqim të përforcuar, shërim klimaterik dhe për veshmbathje, gjykata të njëjtat i refuzoi ngase në bazë gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë si dhe bindjes së gjykatës, del se kjo pjesë e kërkespadiës së paditësit të mitur, është e pabazuar. Mbi bazën e të lartëcekurave, gjykata vlerëson se shumat e kërkuara me kërkesëpadi përtej shumave të aprovuara, nuk janë reale dhe se të njëjtat nuk i përgjigjen gjendjes faktike të vërtetuar për çka edhe kjo pjesë e shumës së kërkuar me kërkespadi, u deshtë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrur konform nenit 452 të LPK-së dhe tarifës zyrtare për përfaqësime dhe atë si në vijim: për dhjetë përfaqësime, secila prej tyre e llogaritur nga 135,00 euro, për përpilimin e padisë 104 euro, për shpenzimet e ekspertizave mjekoligjore dhe atë të aktuaristikës 400 euro, si dhe shpenzimet për taksë gjyqësore 21 euro, respektivisht shumën e tërësishme të shpenzimeve prej 1.875,00 euro.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Procesmbajtësja,
Drita Qerreti

**Gjyqtari,
Valon Totaj**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.